

Nëna e tij Mihrija disa herë e ka vizituar dhe kishte vërejtur në trupin e tij gjurmë të dhunës fizike. Në datën **16.08.1998**, ajo erdhi për ta vizituar të birin, por gardianët i kishin thënë se Ceni ishte dërguar në spital, për shkak të problemeve me lukth. Në të njëjtën natë, Mihrija ka dëgjuar në lajme se Ceni ka vdekur në spital. Në bazë të fotografive të trupit të Cenit, HRW ka konstatuar se ai ka vdekur për shkak të dëmtimeve të organeve të brendshme. Ai u varros në varrezat në Ferizaj/Uroševac. Pas lufte, Ceni është shpallur dëshmor lufte. Në datën 23.08.1999, trupi i tij është rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Ferizaj/Uroševac.

**Burimet:** deklarata M.D, FDH-36772; N. Krašniqi, *Kohë...*, 273; FHP, *Haški tribunal, Sudejni Slobodanu Miloševiću*, XX, 26; NKMDLNJ, *Regjistri i civilëve...*, FDH-13491; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; *Albanian Detainee Dies from Serb Police Torture*, pasqyra e lajmeve, KIC, 19.08.1998, FDH-29433; HRW, *Shkeljet...*, 69, FDH-31132.

## Xhavit (Bajram) Haziri

(3.09.1960, shqiptar nga Prishtina/Priština, punëtor, dy fëmijë)

Xhavit ka qenë i angazhuar politikisht në aksionet kundër pushtetit serb. Për herë të parë është dënuar në vitin 1985 me nëntë vjet burgim. Dënimin e ka vuajtur në Foçë, në Bosnjë e Hercegovinë. Është falur në vitin 1990. Për herë të dytë, në gusht të vitit 1993, është dënuar me pesë vjet burgim, për kinse veprimtari armiqësor. Dënimin e vuante në burgun e Dubravës/Dubrava. Pasi që u lirua, punonte në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në **Prishtinë/Priština**. Në datën **17.09.1998**, rreth orës 11:00, bashkëshortja e dërgoi të birin në shkollë. Pasi që u kthye, Xhavitin nuk e gjeti në shtëpi. Me qenë se ai punonte pasdite, ajo mendonte se Xhavit ishte nisur më herët në punë. Gjatë ditës, ajo ka mësuar se Xhavit nuk ishte paraqitur në zyre në atë ditë. Remzija kishte pritur disa ditë resht, duke besuar se ai ka shkuar në terren që shpesh herë ka ndodhur, por më vonë zhdukjen e tij e ka paraqitur në Këshillin për Mbroj-

tjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe Shërbimin e Punëve të Brendshme. Në polici i kishin thënë se bashkëshortin duhet ta kërkojë në UÇK dhe mos ta kërkojë më në polici. Në kërkim të bashkëshortit, Remzija nga të punësuarit në agjencinë turistike afër Xhamisë së Llapit/Lapska dëgjoi kishte mësuar se ata e kishin parë arrestimin e bashkëshortit të saj më 17.09.1998, në orën 12:40. Sipas dëshmiave të tyre, pjesëtarët e Sigurimit Shtetëror të Republikës së Serbisë e kishin arrestuar Xhavitin dhe e kishin futur në veturën e tipit *Golf II*, me ngjyrë të bardhë dhe me numrin e targave PR 934 - 696. Për fatin e Xhavitit sot e kësaj dite nuk dihet asgjë. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është evidencuar me numër YUK-000044-01.

**Burimet:** deklarata R.H, FDH-18108; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; *Serb Abduct Human Rights Worker in Prishtina*, pasqyra e lajmeve, KIC, 22.09.1998, FDH-29568.

## Zojë (Bajram Preniqi) Prengu

(2.12.1953, shqiptare nga Leshkoshiqi/Leshkovčić, komuna e Obiliqit/Obilić, amvise, dymbëdhjetë fëmijë)

## Kosovare (Ali) Prengu

(3.05.1992, shqiptare nga Leshkoshiqi/Leshkovčić, komuna e Obiliqit/Obilić)

Familja Prengu jetonte në fshatin Leshkoshiqi/Leshkovčić. Pasi që forcat serbe e nisën granatimin e fshatit në qershor të vitit 1998, ata e braktisën shtëpinë. Zhvendoseshin prej fshatit në fshat, kurse, për një kohë më të gjatë, u strehuan në shtëpinë e një miku në Caravodicë/Črkvena Vodica. Në datën **22.09.1998**, forcat serbe e nisën sulmin edhe ndaj këtij fshati, kështu që të gjithë banorët dhe refugjatët ishin të detyruar për t'i braktisur shtëpitë. Zoja, e bija Kosovarja dhe djemtë Shefqeti, Flamuri dhe Demokrati me autobusë shkuan deri në fshatin **Shkabaj/Orlović**. Derisa e kalonin rrugën, një veturë zyrtare e policisë serbe i kishte shkelur Zojën dhe Kosovaren, të cilat gjetën vdekjen në vend. Ato u varrosën më 24.09.1998 në varrezat e fshatit Krushefc/Kruševac, komuna e Obiliqit/Obilić. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, në mars të vitit 2000, familjarët i